



BASHKIA KLOS
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(SPECIALIST)**

Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/Juridike”

Titulli minimal i diplomës “Bachelor”

Në zbatim të nenit 22 dhe 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të VKM nr. 243, datë 18/03/2015, i ndryshuar, Bashkia Klos shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

- **1 (një) Specialist i Planifikimit dhe Ndjekjes së Investimeve në Sektorin e Planifikimit dhe Ndjekjes së Investimeve, Kategoria e pagës IV-a.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	2 Shkurt 2023
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:	9 Shkurt 2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

1. Hartimi apo rishikimi i dokumenteve të planifikimit të territorit në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe, sipas rastit, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe duke iu përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit;
2. Vlerësimin e respektimit të kërkesave ligjore për aplikimet për leje ndërtimi/ zhvillimi apo punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Implementimi, monitorimi dhe përditësimi i planit të përgjithshëm vendor dhe planeve te ndryshme sektoriale dhe ndërsektoriale;
4. Realizon kontrollin fizik të dokumentacionit të plotë teknik dhe ligjor që përmban dosja;
5. Përgatit kërkesat për fonde për hartimin e projekteve dhe thirrjen e investimeve, për studimet urbane, studime ndërtimore dhe materiale të tjera, gjithnjë në bashkëpunim me specialistët përkatës;
6. Realizon detyrat në përputhje me politikat e bashkisë, me standardet administrative dhe procedurat teknike, si dhe duke mbajtur parasysh praktikat profesionale;
7. Identifikon mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave të ndjekura në punën e përditshme të Sektorit;
8. Ndjek vazhdimisht në terren procesin e zbatimit të projekteve të hartuara, duke sqaruar dhe duke i dhënë zgjidhje problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit në bashkëpunim me mbikqyrësat e punimeve;
9. Ndjek vazhdimisht në terren procesin e zbatimit të projekteve të hartuara, duke sqaruar dhe duke i dhënë zgjidhje problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit në bashkëpunim me mbikqyrësat e punimeve;
10. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- d- Të zotërojë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkencat Inxhinierike/Juridike.
- e- Preferohet të ketë eksperience pune në profesion.
- f- Njohja e gjuhës së huaj anglisht ose ndonjë gjuhë tjetër përbën avantazh.
- g- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi.
- h- Njohje të programeve bazë kompjuterike.

1.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose dorazi pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Klos, dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore brenda datës 2 Shkurt 2023 në Bashkinë Klos.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 7 Shkurt 2023 , Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Klos do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;
- b- Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”;
- c- Ligjin nr.107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 73/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
- d- Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar;
- e- Vendimin Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”;
- f- Vendimin Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar;
- g- Vendimin Nr. 12, datë 27.02.2019 “Për Miratimin e Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit, në Njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)”;
- h- Ligjin Nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për Sistemin e Adresave”, i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në:

- 20 pikë përvojë.
- 10 pikë për trainime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse.

- 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet individuale në punë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”
<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Klos, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në stendën e informimit publik të Bashkisë Klos. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJBNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Bashkisë Klos, duke filluar nga data 7 Shkurt 2023.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kriteret e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojë diplomë të nivelit “Bachelor” në Shkencat Inxhinierike.
- b- Preferohet të ketë eksperiencë pune në profesion.
- c- Njohja e gjuhës së huaj anglisht ose ndonjë gjuhë tjetër përbën avantazh.
- d- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi.
- e- Njohje të programeve bazë kompjuterike.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet me postë ose dorazi në DrejtorBurimeve Njerëzore brenda datës 09 Shkurt 2023 në Bashkinë Klos.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 21 Shkurt 2023, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Klos do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Klos, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a- Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”;
- b- Ligjin Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”;
- c- Ligjin nr.107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 73/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- d- Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar;
- e- Vendimin Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”;
- f- Vendimin Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar;
- g- Vendimin Nr. 12, datë 27.02.2019 “Për Miratimin e Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit, në Njësitë që i përkasin Sistemeve Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)”;
- h- Ligjin Nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për Sistemin e Adresave”, i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-datë-27-03-2015>.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Klos do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët, që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbim civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Klos, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbim civil për kategorinë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,

- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Klos duke filluar nga data 21 Shkurt 2023.